

VENDIM
Nr. 587, datë 22.7.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË
MINISTRAVE TË UKRAINËS, PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për transportin ndërkombëtar rrugor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS

PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave i Ukrainës (në vijim të referuara si "Palët Kontraktuese");

Duke pasur parasysh dëshirën për të zhvilluar më tej dhe promovuar transportin ndërkombëtar të udhëtarëve ndërmjet Shqipërisë dhe Ukrainës dhe për të lehtësuar organizimin dhe funksionimin e tij;

Duke marrë parasysh rëndësinë në rritje të turizmit dhe dëshirën për të nxitur më tej shkëmbimin kulturor ndërmjet Palëve Kontraktuese;

Duke synuar të promovojnë transportin e udhëtarëve dhe mallrave me mjete motorike, ndërmjet dhe në transit nëpër territoret e të dy vendeve, kanë arritur në marrëveshje si më poshtë:

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për transportin rrugor ndërkombëtar ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese, përmes territoreve të tyre, në transit dhe për në/nga vende të treta, të kryera nga transportuesit me qira ose me shpërblim, për llogari të tyre, të regjistruar në territorin e një shteti të Palëve Kontraktuese.
2. Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat Palët Kontraktuese janë palë ose i kanë nënshkruar.
3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përjashtojnë kufizimet për transportin rrugor ndërkombëtar, të cilat mund të dëmtojnë sigurinë kombëtare të Palëve Kontraktuese.
4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen, gjithashtu, për lëvizjen e automjeteve bosh, të lidhura me transportin e mallrave dhe udhëtarëve të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet si më poshtë:

1. "Shtet i themelimit" nënkupton territorin e një shteti të Palës Kontraktuese, ku është themeluar transportuesi dhe është regjistruar mjeti.
2. "Shtet pritës" nënkupton territorin e një shteti të një Pale Kontraktuese ku një mjet përdoret për operacione transporti, por që nuk është vendi i regjistrimit të mjetit.
3. "Autoritetet kompetente" nënkupton autoritetet e caktuara nga Palët Kontraktuese për të përmbushur detyrat e kësaj Marrëveshjeje.
4. "Autoritet autorizues" nënkupton autoritetin kompetent të secilës Palë Kontraktuese, në territorin e së cilës është themeluar transportuesi, të cilit i paraqitet aplikimi për një autorizim dhe që ka të drejtë të lëshojë autorizimet/lejet.
5. "Transport ndërkombëtar" nënkupton një udhëtim të kryer nga një mjet:
 - a) me pikë nisjeje dhe mbërritjeje, duke kaluar ose jo transit nëpër territorin e shteteve të Palëve Kontraktuese ose vende të treta;
 - b) ndërmjet vendeve të treta, duke kaluar transit nëpër territorin e një ose të dyja shteteve të Palëve Kontraktuese.
6. "Transportues" nënkupton çdo person fizik ose juridik të regjistruar në territorin e shtetit të njëres nga Palët Kontraktuese dhe të autorizuar për të kryer transport ndërkombëtar të udhëtarëve ose mallrave.
7. "Mjet" nënkupton një mjet motorik të regjistruar në territorin e njëres prej shteteve të një Pale Kontraktuese, ose një kombinim të mjeteve ku të paktën mjeti motorik është i regjistruar në një Palë Kontraktuese dhe përdoret ekskluzivisht për transportin e mallrave.
8. "Autobus linje dhe autobus turistik" nënkupton çdo mjet motorik me konstruksione dhe pajisje të destinuara për transportin e udhëtarëve, i cili ka më shumë se nëntë vende, përfshirë drejtuesin e mjetit dhe është i regjistruar në territorin e njërit shtet të Palëve Kontraktuese.
9. "Shërbime të rregullta" nënkupton shërbimet që ofrojnë transportin e udhëtarëve sipas një orari të dakordësuar përgjatë itinerareve të specifikuar, ku udhëtarët merren dhe zbresin në stacione të paracaktuara.
10. "Shërbime të rregullta të specializuara" nënkupton shërbime të rregullta, të organizuara nga cilido subjekt, të cilat parashikojnë transportin e kategorive të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë.
11. "Shërbime të rastit" nënkupton shërbimet që nuk përfshihen në përkufizimin e shërbimeve të rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të posaçme, dhe karakteristika kryesore e të cilave është transporti i grupeve të udhëtarëve të krijuara me nismën e klientit ose të transportuesit.

12. "Transport me qira ose me shpërblim" nënkupton një operacion transporti të kryer nga një ndërmarrje transporti për kompensim.
13. "Operacioni transporti për llogari të vet" nënkupton operacionet e kryera nga një person fizik ose juridik, ku:
 - a) aktiviteti i transportit është vetëm një aktivitet ndihmës për atë person fizik ose juridik, dhe
 - b) mjetet e përdorura janë pronë e atij personi fizik ose juridik, ose janë marrë nga ai person me kushte të shtyra, ose janë objekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe drejtohen nga një anëtar i stafit të personit fizik ose juridik, ose nga vetë personi fizik, ose nga personel i punësuar apo i vënë në dispozicion të ndërmarrjes në kuadër të një detyrimi kontraktual.
14. "Operacionet e kabotazhit" nënkupton:
 - a) ose shërbimet kombëtare rrugore me qira dhe pagesë që kryhen në një periudhë të përkohshme nga një transportues në një shtet pritës, ose
 - b) marrjen dhe lënien e udhëtarëve brenda të njëjtë shtet, gjatë një shërbimi të rregullt ndërkombëtar, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, me kusht që ky të mos jetë qëllimi kryesor i shërbimit.
15. "Territor i një shteti të Palës Kontraktuese" nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Shqipërisë dhe territorin e Ukrainës.
16. "Autorizim/Leje" nënkupton dokumentin e lëshuar nga autoritetet kompetente të çdo Pale Kontraktuese, i cili i jep të drejtën mjetit ose autobusit të regjistruar në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, të hyjë-dalë dhe të kalojë transit përmes territorit të shtetit të Palës Kontraktuese që ka lëshuar autorizimin/lejen.
17. "Mallra të rrezikshme" nënkupton mallrat që për shkak të vetive dhe karakteristikave të tyre të brendshme, mund të shkaktojnë dëm në harduerë, pajisje, ndërtesa dhe objekte, si dhe vdekje, lëndim ose sëmundje të njerëzve, kafshëve dhe dëm në mjedis gjatë transportimit, ngarkimit, shkarkimit dhe ruajtjes.

TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3 Shërbimet e Rregullta

1. Shërbimet e rregullta ndërmjet territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese që kalojnë përmes tyre transit, duhet të miratohen më parë bashkërisht dhe janë objekt i autorizimit të lëshuar nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.
2. Aplikimi për autorizim duhet të paraqitet nga transportuesi në autoritetin kompetent të shtetit të themelimit. Komiteti i Përbashkët vendos mbi formën e aplikimit dhe dokumentet mbështetëse përkatëse të kërkuara për autorizimin, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese.

3. Autorizimet lëshohen me pëlqimin e ndërsjellë të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.
- a) Vendimi për miratimin ose refuzimin e autorizimit merret brenda një periudhe prej tre muajsh, përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të veçanta.
 - b) Afati i vlefshmërisë së një autorizimi nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet. Ky afat mund të përcaktohet më i shkurtër, ose me kërkesë të aplikantit, ose me vendim të autoriteteve kompetente të njërit prej shteteve ose vendit në territorin e të cilëve udhëtarët merren, zbresin ose kalojnë tranzit.
- 3.1 Çdo autorizim do të përcaktojë si në vijim:
- a) llojin e shërbimit;
 - b) itinerarin e shërbimit, duke specifikuar veçanërisht vendin e nisjes dhe destinacionin, pikat e kalimit kufitar, ndalesat ku udhëtarët hipin ose zbresin dhe, në rastin e shërbimeve të specializuara të rregullta pa kontratë, kategorinë e personave të pranuar për transport dhe destinacionet e tyre;
 - c) një orar bashkëlidhur autorizimit dhe duke përfshirë informacion mbi periudhën e operimit, shpeshtësinë e shërbimeve dhe oraret e ndalesave;
 - d) emrin e operatorit(ëve) të transportit dhe, sipas nevojës, nënkontraktorëve;
 - e) kushte të veçanta të tilla si e drejta dhe kushtet për kryerjen e operacioneve të transportit kabotazh, emri i operatorit që punon nën partneritete të barabarta, nëse ka, etj.;
 - f) afatin e vlefshmërisë së autorizimit.
- 3.2 Autorizimet u japin mbajtësve të tyre të drejtën për të operuar shërbime të rregullta ndërkombëtare për të cilat janë autorizuar në territoret e Palëve Kontraktuese nëpër të cilat kalojnë itineraret e shërbimit.
- 3.3 Ndryshimet në kushtet e operimit dhe anulimi i shërbimit vendosen sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni.
- 3.4 Në rast të mungesës së kërkesës për shërbimin, transportuesi mund ta anulojë atë, duke njoftuar autoritetet kompetente që kanë lëshuar autorizimet si dhe klientët, tre muaj përpara.
- 3.5 Një autorizim për shërbim të rregullt skadon në fund të periudhës së vlefshmërisë së tij ose tre muaj pasi autoriteti autorizues ka marrë njoftim nga mbajtësi i tij mbi qëllimin për tërheqjen e shërbimit. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë të duhur të arsyetuar.
- 3.6 Në rastin kur kërkesa për një shërbim nuk ekziston më, periudha e njoftimit nga mbajtësi i autorizimit, e përcaktuar në paragrafin 3.4 të këtij neni, mund të shkurtohet deri në një muaj, sipas kërkesës së mbajtësit. Autoriteti autorizues do të njoftojë autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përkatëse për humbjen e vlefshmërisë së autorizimit.
- 3.7 Mbajtësi i autorizimit do të njoftojë përdoruesit e shërbimit përkatës për ndërprerjen e tij një muaj përpara, përmes metodave të përshtatshme të informimit publik.

- 3.8 Autorizimet lëshohen në emër të transportuesit dhe nuk mund të transferohen tek transportues të tjerë.

Neni 4 Shërbimet e Rastit

1. Gjatë kryerjes së shërbimeve të rastit, transportuesit të cilët janë të regjistruar në territoret e secilës prej Palëve Kontraktuese, duhet të respektojnë dispozitat e Marrëveshjes Interbus.
2. Shërbimet e rastit të udhëtarëve që nuk mbulohen nga Marrëveshja Interbus, do të kryhen mbi bazën e autorizimeve.
3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë çdo vit një kuotë të dakordësuar autorizimesh për kryerjen e shërbimeve rastësore.
4. Modeli i autorizimit, i miratuar në secilën nga Palët Kontraktuese, si dhe kushtet e përdorimit të tij, do të përcaktohen nga Komiteti i Përbashkët. Në rast të ndryshimeve në modelin e autorizimit nga një prej Palëve, kjo Palë Kontraktuese duhet të informojë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 5 Kushtet Teknike

Kushtet teknike që zbatohen për autobusët e linjave dhe autobusët turistikë, për realizimin e shërbimeve të rregullta ndërkombëtare të mbuluara nga kjo Marrëveshje, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Konventave mbi Trafikun Rrugor, të realizuar në Vjenë më 8 nëntor 1968, si dhe me ligjet kombëtare në fuqi në shtetin pritës.

TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6 Sistemi i Lejeve

1. Transportuesit të themeluar në territorin e një shteti të një Pale Kontraktuese, mund të kryejnë transportin e mallrave pa leje, për:
 - a) transport ndërmjet territoreve të dy Palëve Kontraktuese;
 - b) transport në transit;
 - c) transport ndërmjet pikës në territorin e një shteti të një Pale Kontraktuese dhe pikës në territorin e një shteti të tretë, nëse itinerari kalon nëpër territorin e shtetit ku është regjistruar mjeti.
2. Transporti i mallrave ndërmjet pikës në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe pikës në territorin e një shteti të tretë, do të kryhet me një leje të posaçme, nëse itinerari nuk kalon nëpër territorin e shtetit ku është regjistruar mjeti.
3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese shkëmbejnë çdo vit një numër të dakordësuar lejesh. Lejet do të jenë të vlefshme deri më 31 janar të vitit kalendarik pasardhës.

4. Lejet nuk janë të transferueshme tek transportues të tjerë.
5. Leja mund të përdoret vetëm për një mjet vetëm një herë. Në rastin e kombinimit të mjeteve, faktori përcaktues për lëshimin e lejes ose përjashtimin është mjeti motorik.
6. Komiteti i Përbashkët i ngritur sipas Nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje përcakton kuotën, llojet e lejeve dhe çdo kusht shtesë që rregullon përdorimin e lejeve.

Neni 7

Përjashtimi nga kërkesat për leje

1. Lejet e përmendura në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, nuk kërkohen për:
 - a) transportin me mjete Pesha e Lejuar me Ngarkesë Totale e të cilave (PLNT), duke përfshirë rimorkiot, nuk kalon 6 tonë, ose kur ngarkesa e lejuar, duke përfshirë rimorkiot, nuk kalon 3.5 tonë;
 - b) transportin e mjeteve të dëmtuara ose të prishura, si dhe me mjet të dërguar për të zëvendësuar një mjet të prishur në një shtet tjetër dhe gjithashtu, kthimin pas riparimit të mjetit të prishur;
 - c) transportin e furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për urgjencat, më konkretisht si përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe gjithashtu ndihmës humanitare;
 - d) transportin e objekteve të artit për panaire dhe ekspozita ose për qëllime jo-tregtare;
 - e) transportin e materialeve, aksesoreve dhe kafshëve që përdoren për shfaqje teatrale, muzikore, filmike, sportive ose cirku dhe panaire, si dhe ato që synohen për regjistrime radiofonike, ose për prodhim filmi ose televiziv për qëllime jo-tregtare;
 - f) transportin funeral;
 - g) transportin e postës si një shërbim universal.
2. Komiteti i Përbashkët mund të shtojë ose të heqë kategori transportesh nga lista e përjashtimeve nga kërkesat për leje.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 8

Kabotazhi

1. Administrimi i shërbimeve të kabotazhit në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, është i ndaluar.
2. Ekzekutimi i operacioneve të transportit të kabotazhit, siç është përcaktuar në Nenin 2, do t'i nënshtrohet ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në fuqi në shtetin pritës.

Neni 9

Taksat dhe detyrimet

1. Mjetet që kryejnë transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të regjistruara në territorin e shteteve të njëjës prej Palëve Kontraktuese dhe që ndodhen përkohësisht në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, janë të përjashtuar nga pagesa e të gjitha taksave lidhur me pronësinë dhe regjistrimin e mjetit.
2. Mjetet e Palëve Kontraktuese që kryejnë transportin ndërkombëtar rrugor sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, janë të përjashtuara reciprokisht nga tarifatat, taksat dhe detyrimet doganore në rastet e mëposhtme:
 - a) karburanti për mjetet, i pranishëm në rezervuarët normalë të karburantit të instaluar nga prodhuesi për këtë qëllim dhe i lejuar nga legjislacioni kombëtar i shtetit pritës;
 - b) lubrifikantë, pjesë këmbimi dhe mjete/vegla në sasi të nevojshme për funksionimin normal të automjeteve.

Pjesët e papërdorura të këmbimit duhet të eksportohen nga shteti, dhe ato të zëvendësuara duhet të eksportohen ose shkatërrohen në përputhje me procedurën e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese përkatëse.
3. Detyrimet, tollet/tarifatat dhe tatimet e përdoruesit rrugor, të vendosura për përdorimin e rrjetit rrugor, do të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese dhe me bazë reciprociteti.

Neni 10

Peshat dhe dimensionet

1. Peshat maksimale e lejueshme, peshat e aksit dhe dimensionet e mjeteve duhet të përputhen me ato që janë në dokumentet e regjistrimit dhe gjithashtu, të mos kalojnë kufijtë maksimalë të lejuar që janë në fuqi në vendin pritës.
2. Përdorimi i mjeteve, peshat dhe dimensionet e të cilëve, kalojnë kufijtë maksimalë të lejuar, do të lejohet në vendin pritës vetëm me një leje të posaçme, të kërkuar paraprakisht.

Neni 11

Standardet teknike, pajisjet dhe karakteristikat e tjera

1. Mjetet që kryejnë shërbime rastësore duhet të përputhen me standardet teknike që zbatohen për autobusët e linjave dhe autobusët turistik, që janë në përputhje me Shtojcën 2 të Marrëveshjes Interbus për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, e cila ka hyrë në fuqi më 30 qershor 2001, me ndryshimet përkatëse.
2. Mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të pajisen me pajisjet përkatëse në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme të datës 30 shtator 1957 (ADR), të ndryshuar.

3. Pajisjet që përdoren për të monitoruar kohën e drejtimit dhe periudhat e pushimeve për mjetet, duhet të përpunohen me dispozitat e Marrëveshjes Evropiane për Punën e Ekuipazheve të Mjeteve të Angazhuara në Transportin Ndërkombëtar Rrugor të datës 1 korrik 1970 (AETR), e ndryshuar.
4. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese angazhohen për promovimin e përdorimit të mjeteve që përmbushin standardet e sigurisë dhe ato për emetimet/shkarkimet.

Neni 12

Kontrolli

Lejet dhe dokumentet e tjera përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në të cilat janë pjesëmarrëse dhe/ose legjislacionet kombëtare të Palëve Kontraktuese duhet të mbahen në mjete dhe duhet të paraqiten me kërkesë të çdo inspektori të autorizuar.

Neni 13

Detyrimet e transportuesve dhe shkeljet

1. Transportuesit e Palëve Kontraktuese dhe ekuipazhet e mjeteve të tyre duhet të respektojnë legjislacionin kombëtar të Palës tjetër Kontraktuese, kur ndodhen në territorin e këtij të fundit.
2. Në rastin e shkeljeve të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga një transportues i vendit të një Pale Kontraktuese, autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese në territorin e të cilit ka ndodhur shkelja, pa shkelur procedurat ligjore të vendit të tij, do të njoftojë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, i cili do të ndërmarrë hapat e parashikuar nga legjislacioni kombëtar i vendit të tij.
3. Në veçanti në rastet e shkeljeve të rënda, autoriteti kompetent i vendit pritës mund të ndalojë përkohësisht aksesin në territorin e vendit të tij deri në pranimin e një vendimi nga autoriteti kompetent i shtetit të themelimit. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të mbajnë reciprokisht të informuar njëra-tjetrën për vendimet e marra.
4. Në të gjitha rastet që nuk janë rregulluar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose nga detyrimet ndërkombëtare përkatëse, për të cilat të dyja shtetet e Palëve Kontraktuese janë palë, transportuesit e Shtetit të një Pale Kontraktuese duhet të respektojnë kërkesat e legjislacionit dhe rregullat kombëtare që zbatohen Shtetin e Palës tjetër Kontraktuese, gjatë qëndrimit në territorin e këtij të fundit.
5. Në rast ndryshimesh në legjislacionin e njëres prej Palëve Kontraktuese, autoriteti kompetent i atij shteti do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për këtë qëllim.

Neni 14

Komiteti i Përbashkët

1. Për qëllim të zbatimit të duhur të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të krijojnë një Komitet të Përbashkët, të formuar nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese dhe ekspertë për çdo çështje të caktuar.

2. Komiteti i Përbashkët do të shqyrtojë çështjet mbi transportet rrugore ndërkombëtare, të cilat janë me interes të ndërsjellë dhe do të zgjidhë çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha çështjet e shqyrtuara mund të përcaktohen në Protokollin e Komitetit të Përbashkët.
3. Komiteti i Përbashkët do të takohet me kërkesë të njëres prej Palëve Kontraktuese dhe këto mbledhje do të zhvillohen të alternuara në territorin e shtetit të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 15 **Autoritetet Kompetente**

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Për Kabinetin e Ukrainës: Ministria për Zhvillimin e Komuniteteve dhe Territoreve.

Në rast të ndryshimeve të autoriteteve kompetente të përcaktuara në këtë paragraf, emrat e autoriteteve kompetente do të komunikohen tek Pala tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet përmes konsultimeve nga Komiteti i Përbashkët ose, nëse kjo nuk është e mundur, përmes kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 17 **Ndryshimet**

Palët Kontraktuese, me miratim të ndërsjellë, mund të bëjnë ndryshime në këtë Marrëveshje duke lidhur protokolle shtesë, të cilat do të bëhen pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Këto protokolle do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurës që kërkohet për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, siç është përmendur në Nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 18 **Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe zgjidhja e marrëveshjes**


1. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga Palët Kontraktuese, përmes kanaleve diplomatike, se të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përbushur.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund të ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me njoftim mbi denoncimin, të dërguar Palës tjetër Kontraktuese, përmes kanaleve diplomatike. Afati i vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje do të skadojë 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes të një njoftimi të tillë.

Nënshkruar në Tirane në datën 16.6, 2026, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, ukrainase, dhe angleze, ku të gjithë tekstet janë njëjloj autentikë.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



**PËR KABINETIN E MINISTRAVE
TË UKRAINËS**

